



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.147/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses “A...” N.P.SH., me seli në Prishtinë, kundër të paditurës “A...” me seli në Gjilan, për kompensim borxhi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.180/19 i datës 06/07/2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **18/01/2021**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e paditëses “A...” N.P.SH., me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.180/19 i datës 06/07/2020.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin e ankimuar I.EK.nr.180/19 i datës 06/07/2020, ka vendosur si në vijim:

I. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses “A...”, N.P.SH, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura “A...”, që paditëses t’ia paguaj shumën prej 2,730.00 €, në emër të borxhit të mbetur nga kontrata për ofrimin e shërbimeve të internetit.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësja në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të prishet aktgjykimi i atakuar apo të aprovohet kërkesëpadia.

Pala e paditur nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja "A..." N.P.SH., me seli në Prishtinë, pranë Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 17/09/2008, ka paraqitur padi kundër të paditurës "A...", me seli në Gjiilan, me kërkesë të precizuar si në dispozitivin e aktgjyimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se të njëjtit ish-in në raporte kontraktuese që nga data 07/06/2007, ku paditësja e ka furnizuar të paditurën me shërbime të internetit e gjithashtu nuk ishte kontestuese se paditësja nuk ka lëshuar fatura në baza mujore përveç faturës kontestuese me nr.04/0511-2008 e datës 01/04/2008 e cila nuk është pranuar në dorëzim, nënshkrim dhe vulosje nga pala e paditur, me tutje në arsyetim të aktgjyimit theksohet se pagesat janë bërë në formë të parapagimit, ku për shërbimet e ofruara për një muaj kalendarik pagesa është dashur të bëhet në fillim të muajit dhe me kërkesën e të paditurës është krijuar marrëdhënia e parapagimit të shërbimit dhe i padituri nuk e ka shfrytëzuar internetin gjatë muajit prill të vitit 2008, sepse i ka shitur të gjitha asetet e biznesit të tij e rrjedhimisht nuk e ka bërë as parapagimin dhe mbi bazën e kësaj gjendje faktike ka vendosur si në dispozitivin e aktgjyimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 17.1, nenin 261.1 të LMD-së dhe nenit 143 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikë n) të LPK, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë sepse në bazë të Kontratës mbi nivelin e shërbimit, termat dhe konditat e shfrytëzimit të shërbimit palët kontraktuese i kanë rregulluar të drejtat dhe detyrimet e tyre kontraktuese, ashtu që në nenin 2.1 kanë paraparë: *“Klienti do të paguaj për parapagimin e shërbimeve deri me datën 1 të çdo muaji dhe vonesat e pagesës së rregullt mujore automatikisht nënkupton shkëputje të marrëdhënies së parapaguesit dhe shfrytëzuesit të shërbimeve dhe me këtë të gjitha shpenzimet e kontraktuara nga parapaguesi do të suspendohen pa paralajmërim”*. Në rastin konkret fatura kontestuese Nr.04/0511-2008 e datës 04/01/2008 e lëshuar nga paditësjja, rezulton se nuk është pranuar e as nënshkruar nga e paditura e që nënkupton se e njëjta nuk i ka pranuar as shërbimet e internetit e gjithashtu nuk e ka bërë as parapagimin e shërbimit dhe sipas kësaj dispozite kontraktuese në këto raste është paraparë se nëse e paditura nuk e pagunë parapagimin deri me datën 1 të çdo muaji, atëherë nënkupton se marrëdhënia juridike është shkëputur dhe në të njëjtën kohë janë ndërprerë të gjitha shërbimet e internetit, ndërsa nga Marrëveshja e Transferimit të Aseteve, rezulton se e paditura ia ka shitur të gjitha asetet, kompanisë “Kujtesa”, po ashtu kjo gjykatë i vlerësoj si të pa bazuara edhe pretendimet e të autorizuarit të paditëses se kinse e paditura e ka pohuar shfrytëzimin e internetit dhe lartësinë e borxhit, për arsye se me provat e administruara nuk është argumentuar një pretendim i tillë ankimor, përkundrazi e paditura gjatë gjithë rrjedhjes së procedurës kontestimore e ka kontestuar padinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia e saj.

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se në rastin konkret është zbatuar drejt e drejta materiale, për shkak se nuk janë plotësuar kushtet ligjore që të aplikohet neni 8.1 të LMD-së e cila dispozitë ka paraparë: *Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe*

janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit, e po ashtu nuk janë plotësuar as kushtet e parapara me neni 262 par.1 të LMD-së e cila normë juridike parasheh: Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij. Andaj në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të pa themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte drejtpërdrejt në ligshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
Ae.nr.147/20, me datën 18/01/2021

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku, d.v